



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
REKTORATI**

Nr. 1141/13 Prot.

Vlorë më, 22 . 04 .2026

**VENDIM**

Nr. 12 , datë 22 / 04 / 2026

**PËR**

**MIRATIMIN E PROJEKT-PROPOZIMEVE TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE  
HUMANE, NË KUADËR TË PROGRAMIT TË KËRKIM-ZHVILLIMIT (PKZHUV),  
TË FINANCUARA NGA BUXHETI I UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI",  
VLORË, PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të nenit 93, 95, pika 1, 2, 3, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 26, pika 3, dhe kreut IX të Statutit të UV-së; nenit 8, pika 6, 7 dhe 8, të Rregullores për Projektet të Kërkim-Zhvillimit të financuara nga buxheti i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; vendimit të Senatit Akademik të UV-së nr. 16, datë 06.05.2021, si dhe referuar shkresës së Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, me nr. 1033/1 prot., datë 16.04.2026; Rektorati, në mbledhjen e datës 22.04.2026,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë projekt-propozimet me financim nga Buxheti i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë (PKZHUV), të paraqitur nga Fakulteti i Shkencave Humane, si më poshtë:
  - Fuqizimi I kapaciteteve komunikuese dhe gjuhësore në gjuhë të huaj të stafit, si shtyllë e strategjisë së internacionalizimit të UV-së
  - Kanuni I Labërisë – një monument I trashëgimisë kulturore e gjuhësore të Labërisë
  - Dezinformimi në Hapësirën Digjitale dhe Sfidat e tij juridike
  - Përdorimi I shqipes standard në komunikimin institucional dhe publikimet online në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë
  - Studentët e Fakultetit të Shkencave Humane dhe detyrimi ligjor për zbatimin e të drejtave të autorit: Praktikat aktuale dhe nevoja për ndërgjegjësim.
  - Studenti dhe Universiteti: Analiza e përvojës Akademike dhe sfidave në Universitetin e Vlorës
  - Guidë Arkeologjike e Qarkut Vlorë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
REKTORATI

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Administratori dhe Drejtorja e Shërbimeve Ndihmës Akademike në UV.
3. Një kopje e këtij vendimi i bëhet me dije Fakultetit të Shkencave Humane.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR  
Prof.Dr. Aurela Saliaj

